

UDHËZIM
Nr.965, datë 11.12.2007

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRANSFERIMIN E
AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË NJËSITË
E QEVERISJES VENDORE”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore”, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZON:

I. Transferimi i aksioneve dhe mbledhja e parë e asamblesë

1. Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.09.2007 Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerr urdhrin për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve të njësitë e qeverisjes vendore.

2. Urdhri do të përmbajë të gjitha ndryshimet në aktet e themelimit të këtyre shoqërive.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës kryen procedurën e depozitimit të këtij urdhri në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me aktet e themelimit të ndryshuara të shoqërisë.

4. Rendi i ditës për zhvillimin e mbledhjes së asamblesë do të përcaktohet nga drejtori i shoqërisë për probleme të cilat nuk janë kompetencë e Këshillit Mbikëqyrës. Drejtori i shoqërisë do t'i njoftojë aksionarët 15 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes dhe do t'u vërë në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes. Në mbledhjen e parë të asamblesë së aksionarëve do të marrë pjesë një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (anëtari i METE-s në Këshillin Mbikëqyrës të kësaj shoqërie). I gjithë dokumentacioni i mbledhjes do t'i vihet në dispozicion aksionarëve të shoqërisë 15 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes, duke i përcaktuar mënyrën e përfaqësimit të tyre në mbledhje (aktin e përfaqësimit). Qëndrimi që do të mbajë përfaqësuesi i aksionarëve në këtë mbledhje do të jetë me shkrim dhe i miratuar nga organi të cilin ai përfaqëson.

II. Procedurat e mbledhjes së asamblesë së aksionarëve të shoqërive

1. Mbledhjet e asamblesë së aksionarëve, e zakonshmja dhe e jashtëzakonshmja, zhvillohen në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga Këshilli Mbikëqyrës apo Drejtori i Përgjithshëm. Në mungesë ajo mund të thirret, gjithashtu nga: a) eksperti kontabël i autorizuar, b) një mandatmbajtës, i caktuar nga gjyqi, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent ose c) nga likuiduesi, si dhe me kërkesë të aksionarëve që zotërojnë të paktën 10% të aksioneve të shoqërisë.

2. Thirrja e asamblesë së aksionarëve bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore. Në rast se të gjitha aksionet janë nominative apo në rast se shoqëria ka një aksionar të vetëm, përveç botimeve të parashikuara në paragrafin e mësipërm duhet të dërgohet dhe një njoftim i dërguar me letër rekomande në adresën e çdo aksionari me shpenzimet e shoqërisë.

3. Njoftimi duhet të bjerë në dorën e aksionarëve apo të njihet prej tyre, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë përcakton ditën, orën dhe vendin ku bëhet mbledhja, si dhe natyra e jashtëzakonshme, të zakonshme apo të veçantë të rendit të ditës. Në rast nevojë, ai tregon vendin ku duhet të depozitohen aksionet për prurësin ose certifikata e depozitimit të këtyre aksioneve, për të lejuar të drejtën e pjesëmarrjes në asamble dhe afatin e fundit të këtij depozitimi.

Çdo mbledhje asambleje që thirret në mënyrë të parregullt, mund të anulohet.

Megjithatë veprimi i anulimit nuk pranohet, kur të gjithë aksionarët janë prezentë apo të përfaqësuar.

Mënyra dhe forma e njoftimit të aksionarëve dhe e zhvillimit të mbledhjes së asamblesë është ajo e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar për shoqëritë tregtare.

4. Në thirrjen e mbledhjes së asamblesë duhet të jetë përcaktuar dhe rendi i ditës, i cili përcaktohet nga autori i thirrjes së saj. Megjithatë një apo disa aksionarë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit, u njihet e drejta për të futur në rendin e ditës disa projektrezoluta. Këto projektrezoluta dërgohen në selitë e

shoqërisë të shoqëruara me shkresë përcjellëse dhe me dokumentin ku vërtetohet zotërimi apo përfaqësimi i pjesës së kapitalit të kërkuar, sipas paragrafit të dytë të këtij neni.

Rendi i ditës i mbledhjes së asamblesë nuk mund të ndryshohet në lajmërimin e dytë.

5. Asambleja e zakonshme merr çdo vendim, përveç atyre që në bazë të ligjit apo këtij statuti duhen marrë nga asambleja e jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar. Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm në qoftë se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën 1/2 e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën duhet të marrin pjesë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar, që zotërojnë të paktën 1/4 e aksioneve me të drejtë vote.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicën e votave, që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

6. Vetëm asambleja e jashtëzakonshme ka kompetenca të ndryshojë statutin me të gjitha dispozitat e tij. Çdo klauzolë e kundërt konsiderohet e pavlefshme.

Asambleja e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën 2/3 e aksioneve dhe në të dytën 1/2 e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e asamblesë mund të shtyhet për një datë të mëvonshme, jo më larg se dy muaj nga data e thirrjes së parë.

Ajo merr vendim me një shumicë votash prej 4/5 që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

7. Në mbledhjet e aksionarëve përfaqësuesit e bashkive/komunave, paraqiten me autorizimin dhe qëndrimin për rendin e ditës të dhënë nga këshilli komunal/bashkiak. Çdo përfaqësim pa këtë autorizim dhe qëndrimin përkatës të këshillit komunal/bashkiak është i pavlefshëm. Vendimet në asamble merren në bazë të rregullave të përcaktuara në statut dhe në mungesë të përcaktimit të tyre në ligjin për shoqëritë tregtare.

8. Asambleja e aksionarëve drejtohet nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës apo në mungesë të tij nga një person i autorizuar nga kryetari.

Kryetari i asamblesë asistohet nga një sekretar i emëruar nga asambleja e aksionarëve.

Procesverbali i çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë tregon datën dhe vendin e mbledhjes, mënyrën e thirrjes, rendin e ditës, emrat e drejtuesit dhe sekretarit të asamblesë, numrin e aksioneve me të cilat është votuar dhe kuorumi i arritur, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë, një përmbledhje të debateve, tekstin e vendimeve të kaluara për votim dhe rezultatin e votimit. Procesverbali firmoset nga kryetari dhe sekretari i asamblesë dhe duhet noterizuar nga një noter i pranishëm në mbledhjen e asamblesë.

III. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillave Mbikëqyrës dhe mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës.

1. Anëtarët e Këshillave Mbikëqyrës zgjidhen në bazë të statutit të shoqërisë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata duhet të kenë:

- të paktën eksperiencë 5-vjeçare pune në degë të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë;

Preferohen profesionet inxhinier, ekonomist, jurist, mundësisht me formim pasuniversitar.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të zgjedhur nga asambleja, mund të shkarkohen në çdo moment nga kjo e fundit për shkaqe të përligjura. Pavarësisht parashikimeve të kësaj pike, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të përcaktuar nga aksionarët që zotërojnë më pak se 1/2 e aksioneve të shoqërisë, nuk mund të shkarkohen pa propozimin e këtyre aksionarëve.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përfitojnë shpërblim për pjesëmarrje në Këshill në bazë të akteve nënligjore në fuqi.

2. Në rastin e vendeve bosh që krijohen nga vdekja apo dorëheqja e një apo disa anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ky Këshill mundet, për periudhën midis dy mbledhjeve të asamblesë, të bëjë emërtime të përkohshme duke pasur parasysh parashikimet e nenit 15 të statutit.

3. Kur numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ka zbritur nën minimumin ligjor, drejtori i përgjithshëm duhet të thërrasë urgjentisht mbledhjen e zakonshme të asamblesë për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

4. Emërimet e bëra nga Këshilli Mbikëqyrës, në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, i nënshtrohen ratifikimit në mbledhjen e radhës së asamblesë së zakonshme. Në mungesë të ratifikimit, shqyrtimet e bëra dhe vendimet e marra më parë nga Këshilli Mbikëqyrës mbeten gjithmonë të vlefshme.

5. Nëse një ose disa vende të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqje të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, zëvendësimi i tyre duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre)

muaj nga koha në të cilën vendi ka mbetur bosh.

6. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

7. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të emëruar nga asambleja, nuk mund të jenë nga të punësuarit në shoqëri.

8. Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të bëjë pjesë në më shumë se 2 (dy) këshilla mbikëqyrës të shoqërive anonime që kanë seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikëqyrës dhe mund të jenë të rizgjedhshëm.

10. Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton këtij dhe pagën.

11. Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës drejtohen nga zëvendëskryetari.

12. Këshilli Mbikëqyrës mblidhet jo më vonë se një herë në tre muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë anonime, me thirrjen e kryetarit ose në mungesë të tij të zëvendëskryetarit.

13. Kryetari dhe në mungesë të tij zëvendëskryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, kur drejtori i përgjithshëm ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

14. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkuar mund të thërrasin Këshillin duke e përcaktuar rendin e ditës.

15. Në parim, thirrja duhet të bëhet 3 (tre) ditë përpara me letër, telegram, teleks ose telefaks, por thirrja mund të jetë e vlefshme edhe me gojë dhe pa afat, në qoftë se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e pranojnë atë.

16. Çdo thirrje duhet të tregojë çështjet kryesore të rendit të ditës.

17. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.

18. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij.

19. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit është përcaktuese.

20. Këshilli Mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhjen e tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje.

21. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës evidentohen në procesverbalet e hartuara në parim me dispozitat ligjore në fuqi, nga sekretari i Këshillit Mbikëqyrës.

22. Kopje të këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari (ose në mungesë të zëvendëskryetarit) dhe sekretari.

23. Këshilli Mbikëqyrës emëron dhe shkarkon drejtorin e përgjithshëm të shoqërisë me votat e 5 anëtarëve të tij në rast se Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 anëtarë dhe me votat e 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, në rast se numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është i ndryshëm nga 6.

24. Këshilli Mbikëqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga drejtoria dhe i jep kësaj të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga drejtoria pa autorizimin e Këshillit Mbikëqyrës.

25. Me emërimin e drejtorit të përgjithshëm Këshilli Mbikëqyrës lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.

IV. Drejtori i përgjithshëm

1. Shoqëria administrohet nga drejtori i përgjithshëm.

2. Drejtori i përgjithshëm ka të drejtë që brenda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të kompanisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit.

3. Drejtori i Përgjithshëm është person fizik, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Për t'u

zgjedhur drejtor i përgjithshëm, personi duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.400, datë 19.8.1999. Ai mund të zgjidhet edhe jashtë të punësuarve në shoqëri. Nëse një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës emërohet drejtor i përgjithshëm mendati i tij në Këshillin Mbikëqyrës përfundon. Një person nuk mund të emërohet drejtor i përgjithshëm në më shumë se një shoqëri. Ai nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç.

4. Drejtori i përgjithshëm mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës për shkaqe të përligjura. Drejtori i përgjithshëm emërohet për një periudhë kohe prej katër vjetësh, por mbi baza kontratash të rinovueshme vjetore. Drejtori i përgjithshëm mund të riemërohet.

5. Paga e drejtorit të përgjithshëm caktohet nga Këshilli Mbikëqyrës në aktin e emërimit të tij.

6. Drejtori i përgjithshëm ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.

7. Në marrëdhëniet me të tretët shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e nënshkruara nga drejtori i përgjithshëm edhe kur këto akte e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i drejtorit të përgjithshëm kapërcen objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe vepronte me keqbesim ose, kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e Statutit nuk është provë e mjaftueshme. Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e drejtorit të përgjithshëm duhet të respektohen nga të tretët.

8. Aktet me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.

9. Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet apo me vlerë mbi 2 (dy) milionë lekë bëhet me autorizim të Këshillit Mbikëqyrës. Në rastet emergjente dhe pamundësie për të mbledhur Këshillin Mbikëqyrës, për kontratat që i kalojnë limitet e mësipërme duhet marrë miratimi me shkrim i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe në mungesë të tij të zëvendëskryetarit. Këta të fundit njoftojnë në mbledhjen e parë të Këshillit Mbikëqyrës, këtë të fundit, për autorizimin e dhënë.

10. Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

11. Drejtori i përgjithshëm bën strukturën e organizimit të shoqërisë të cilën e miraton Këshilli Mbikëqyrës.

V. Miratimi i programeve të zhvillimit të këtyre shoqërive

1. Projektprograme të zhvillimit ekonomik hartojnë të gjitha shoqëritë publike ujësjellës-kanalizime me kapital shtetëror.

2. Hartimi i projektprogrameve të zhvillimit ekonomik të shoqërive bëhet për periudha 12 vjeçare, afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me objektivat e caktuara nga organet drejtuese të tyre.

3. Hartimi i projektprogrameve të zhvillimit ekonomik mbështetet në strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik e social, në strategjinë sektoriale dhe aktet ligjore në fuqi. Për hartimin e projektprogrameve kërkesat, afatet dhe mënyra e paraqitjes së treguesve parashtrihen duke respektuar afatet kohore të hartimit të Projektbuxhetit të Shtetit për të njëjtat periudha programimi.

4. Projektprogramet vjetore të zhvillimit ekonomik hartohen nga drejtoria e shoqërisë dhe miratohen nga organet vendimmarrëse të saj, sipas treguesve të kërkuar nga asamblëja e aksionarëve si përfaqësuese e pronarit.

5. Drejtoritë e shoqërive ujësjellës-kanalizime për të cilat njësitë e qeverisjes vendore përfaqësojnë pronarin, dërgojnë një kopje të projektprogramit të zhvillimit ekonomik për vitin pasardhës dhe relacion shpjegues, fillimisht në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë brenda datës 30 gusht të çdo viti. Dërgojnë, gjithashtu në këtë afat për mendim një kopje të projektprogramit në ministrinë e linjës administrative, e cila ka kompetencën të monitorojë nevojat për fonde buxhetore në këto shoqëri dhe të programojë miratimin analitik të tyre, në përputhje me mundësitë për financime buxhetore.

6. Mbi bazën e tabelave të projektprogramit të ripunuar dhe relacionit të përgatitur prej drejtorisë së shoqërisë (në të cilat reflektohen sugjerime të mundshme të Ministrisë së linjës administrative), Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë merr vendimin për miratimin e këtij projektprogrami. Vendimi miratues i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë duhet të pasqyrojë detyrimisht në shifra nivelet e programuara të treguesve kryesore të zhvillimit të shoqërisë dhe propozime të tjera që ndikojnë në rritjen e performancës së saj.

7. Projektprogrami për vitin pasardhës dërgohet prej drejtorisë së shoqërisë për miratim përfundimtar në asamblëne e aksionarëve të shoqërisë brenda datës 1 dhjetor të çdo viti. Në këtë rast, praktika e projektprogramit që dërgohet për miratim përfundimtar përmban:

- Relacionin shpjegues të drejtorisë së shoqërisë për projektprogramin.
- Tabelat e projektprogramit të shoqërisë, ku reflektohen sugjerimet që disponohen prej drejtorisë së shoqërisë.

- Një kopje të sugjerimeve që mund të jenë paraqitur prej ministrisë së linjës administrative lidhur

me projektprogramin e shoqërisë.

- Një kopje të vendimit miratues të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë për këtë projektprogram.

8. Të gjithë treguesit e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë duhet të bazohen në përlllogaritje analitike të specialistëve, të kontrolluara prej drejtorisë së shoqërisë.

Përpiluesit e projektprogramit të zhvillimit dhe drejtoria e shoqërisë mbajnë përgjegjësi për bazueshmërinë në aktet ligjore e nënligjore në fuqi të përlllogaritjeve analitike, mbi bazën e të cilave janë hartuar treguesit e propozuar për miratim.

9. Vetëm për raste të veçanta, kur ndryshimet e pjesshme gjatë vitit në programin e miratuar të shoqërisë diktohen nga faktorë të pamundur të parashikohen në projektprogram nga organet drejtuese të shoqërisë dhe janë objektivisht të pashmangshme, ndiqet e njëjta procedurë ndryshimi i programit të zhvillimit, si në rastin e miratimit të programit fillestar të shoqërisë.

10. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve raportojnë tek organet drejtuese të shoqërisë mbi realizimin operativ të treguesve kryesorë të programit vjetor të zhvillimit ekonomik dhe financiar. Afati i dërgimit të materialit të raportimit është sa herë që e gjykojnë të nevojshme ose t'u kërkohet prej tyre, por jo më rrallë se një muaj pas mbylljes së çdo 3-mujori.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Genc Ruli